

INTERVISTË E AMBASADORIT LAWRENCE BUTLER
LOBI, 24 SHTATOR 2004

REFERENDUMI VENDOS: VONIM OSE RRUGË DREJT BE-SË DHE NATO-S



“Cilat janë implikacionet e votimit ‘për’ apo ‘kundër’? Për mua implikacionet janë shumë të qarta. Nëse votoni “për”, Maqedonia ballafaqohet me pasiguri dhe vonesa. Nëse refuzojnë referendumin dhe zgjedhin pakon e organizimit të propozuar të komunave, e dimë se ku çon kjo.

Edhe në këtë rast ekzistojnë disa pasiguri, por me të vërtetë kjo rrugë shpie drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian, pa asnjë vonesë. Dhe kjo është ajo çka është me rëndësi”, thotë ambasadori i SHBA-ve në Shkup.

LOBI: Kishit një mëngjes pune me Komisionin Ndërkombëtar për Ballkanin, ku ndoshta keni diskutuar për situatën e tanishme në Maqedoni. Cila është pikëpamja juaj për situatën tonë?

Butler: Ishte një grup interesant i njerëzve, që përfshinte ish-kryetarin Gligorov, ish-ambasadorin amerikan në Bullgari, ish-kryeminitrin italian, Amato. Një grup i përzier interesant: grekë, turq, të cilët lexojnë dhe mendojnë shumë për Maqedoninë dhe pyetjet ishin rreth situatës në vend, implementimit të Marrëveshjes-kornizë dhe se çka mendoj unë për 7 nëntorin. Atyre u tregova për perspektivat e mia trevjeçare, se si Maqedonia ka përparuar në një ambient shumë të sigurt nga ai kur policët nuk mund të depërtonin në vende të caktuara, ku qytetarët nuk kishin siguri për të vozitur në vende të caktuara; ne po debatonim se a janë shumë të larta kamatat për ndërmarrjet e vogla dhe mesatare, gjithashtu diskutuam se a shpejtojnë gjyqtarët në dhënien e vendimeve, pse shumë investitorë të huaj investojnë këtu. Ata vlerësuan perspektivën e termit mesatar. Në perspektivë afatshkurtër biseduam rreth asaj se çfarë mund apo nuk mund të ndodhë më 7 nëntor.

LOBI: Pra, keni shfaqur pikëpamjet tuaja optimiste për situatën në vend. A nuk u ndryshua kjo me atmosferën që u krijua me referendumin?

Butler: Jo. Në shumë mënyra, referendumi - kjo mund të jetë paksa kontradiktore me atë çka kam deklaruar para disa javëve - maqedonasve ua jep një rast tjetër që të tregohen të matur dhe të mençur për të ardhmen. Sa herë që qytetarët e këtij vendi janë kërkuar të bëjnë zgjedhje, ata kanë bërë zgjedhjen e duhur. Nuk shoh se atmosfera është përkeqësuar, pasi kemi një debat demokratik shumë solid. Njerëzit janë të lirë për të shprehur mendimet e tyre, jo doemos duhen të jenë dakord me të gjitha opinionet, por kjo ndoshta është një nga momentet e rralla, ku kemi njerëz që ngriten për të thënë atë çka mendojnë për pyetjet e paraqitura me referendumin.

Mesazhi që kisha për grupin në këtë mëngjes pune ishte se nuk po jemi neutralë në lidhje me këtë referendum. Pse nuk jemi neutralë? Sepse, referendumi është një zgjedhje ndërmjet status quo-s dhe ligjit që u miratua para gjashtë javëve, zgjedhja është ndërmjet

123 komunave dhe 84 komunave, zgjedhja është ndërmjet moszbatimit dhe mosrealizimit të Marrëveshjes-kornizë, sepse për një të ardhme të parashikueshme, nëse referendumi arrin sukses, atëherë nuk do të ketë decentralizim siç parashihet në Marrëveshjen-kornizë (artikulli 3- decentralizim më i madh i qeverisë). Apo zgjedhja është marrja e obcionit të ligjit që u miratua, të cilin ne dhe ekspertët e kemi vështruar me kujdes dhe ai i plotëson kriteret minimale për komunat e suksesshme, rrit larminë etnike të komunave, nuk zvogëlon por rrit atë, ndërsa zvogëlon numrin e komunave dhe bile edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Banka Botërore thonë se me gjasë këto komuna do të mbijetojnë ekonomikisht me përgjegjësitë e reja që do t'i marrin. Më e rëndësishme për perspektivën tonë, të BE-së, NATO-s dhe ndoshta edhe të institucioneve evro-atlantike është se një nga kriteret për anëtarim është implementimi i Marrëveshjes-kornizë.

LOBI: A mendoni me të vërtetë se referendumi bëhet për organizimin territorial?

Butler: Jam i sigurt se ka motive tjera të shumta nga ana e njerëzve që nënshkruan petitionin. Nga biseda ime me ta, e di se ka edhe motive të ndryshme nga ana e organizatorëve, nga të cilët disa prej tyre janë anëtarë të opozitës dhe dëshirojnë të jenë në pozitë. Referendumin e shohin si një mënyrë për të pasur zgjedhje të parakohshme dhe mbase mund të fitojnë dhe të udhëheqin shtetin sërish. Mendoj se ka disa prej tyre që janë kundër Marrëveshjes-kornizë. Jam rikujtuar në deklaratat e tyre të dhëna në vitin 2001. Atyre nuk iu pëlqente Marrëveshja-kornizë në atë kohë dhe e njëjta ndodh edhe sot. Mendoj se disa nga ta nuk janë në favor të integritetit evro-atlantik. Kam parë se çfarë kanë deklaruar në vitin 2001 dhe 1999, si dhe po shoh se çka deklarojnë sot dhe nuk shoh ndonjë dallim të madh. Ka edhe njerëz që me të drejtë interesohen për t'u kthyer prapa ku kanë qenë në vitin 1996 dhe mund të them se shkojnë në pasiguri. Njerëzit çdoherë preferojnë status quo-në. Ajo për të cilën unë brengosem dhe çka shoh në realitet (këtë mund ta vëreni nga balta në këpucët e mia nga shëtitja ime përreth vendit) është se shoh komuna ku dritat po shuhet. Për çdo ditë dritat po shuhet në komunat në mbarë Maqedoninë dhe kjo duhet të marrë fund. Gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë Maqedonisë është ajo çka ndodhi në vitin 1996, kur u formuan 123 komuna etnikisht të pastra. Dhe, përveç kësaj, ato nuk ishin të qëndrueshme, nuk kishin rrymë, nuk mund të ndërtonin trotuare, shkolla të reja, as t'i mbledhnin tatimet, si dhe nuk mund të bënin asgjë përveç se të lusin qeverinë për t'iu dhënë të holla. Kjo nënkuptoi se pushteti u kthye në Shkup dhe banorët e gjithë komunave ishin tërhequr në Shkup. Dhe, nëse i takonit partisë së djathtë, mbase komuna juaj do të merrte të holla të mjaftueshme për të ndërtuar shkollë të re apo diç tjetër.

Jam i sigurt se ekzistojnë shumë motive, por na duhet të fokusohemi se cilat janë implikacionet. Cilat janë implikacionet e votimit "për" apo "kundër". Për mua implikacionet janë shumë të qarta. Nëse votoni "për", Maqedonia ballafaqohet me pasiguri dhe vonesa. Rrëmujë politike, zgjedhje të reja, mendoj ekzistojnë mundësi të shumta dhe nuk dua të spekuloj. Nëse refuzojnë referendumin dhe zgjedhin pakon e organizimit të propozuar të komunave, e dimë se ku të çon kjo. Edhe në këtë rast ekzistojnë disa pasiguri, por me të vërtetë kjo rrugë shpie drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian pa asnjë vonesë. Dhe kjo është ajo çka është me rëndësi. Vonesë, ndalim, ecje në rreth, dhe do të ketë pyetje, mbase edhe liderë të rinj dhe unë pyetem se a i dëshironi këta liderë që të udhëheqin sërish me shtetin. Ata u përpoqën të bëjnë këtë para disa vitesh, por nuk bënë punë të mirë, mbase duan të mbarojnë punën. Ose ju ndoshta

dëshironi t'i mbani gjërat në këtë kahje, mbase kemi pyetje rreth kësaj, por në demokraci keni rastin të ndërroni mendje çdo katër vite. Ndërrimi i ardhshëm i mendjes është në vitin 2006. Jemi shumë komfort me organizimin e ri territorial. Siç e thashë, nuk jemi neutralë, nuk jemi të paanshëm në këtë çështje. Në çka nuk jemi neutralë është se jemi në favor të Marrëveshjes-kornizë. Vendi im është një nga dëshmitarët dhe një nga garantuesit. Besojmë në sundimin e së drejtës, referendumi kërkohet me kushtetutë, organizatorët i kanë plotësuar të gjitha kërkesat për ta mbajtur. Është një realitet. Votuesit e Maqedonisë duhet të bëjnë zgjedhjen.

LOBI: Referendumi po krijon disa probleme politike. Ku mendoni se është bërë gabimi?

Butler: Kur ngjitem në mal, kam dëshirë të ndalem dhe të kthej kokën poshtë dhe të shoh se nga jam nisur dhe ku kam arritur. Gjatë ngjitjes në mal në errësirë, nuk ke aspak idenë se sa larg ke arritur dhe çfarë përpjekjesh u desh për të arritur në cakun e dëshiruar dhe për t'i kaluar pengesat në rrugë. Që nga koha kur maqedonasit dolën në referendum në vitin 1991 për të vendosur se a e duan apo jo pavarësinë nga RFJ, ky vend ka tejkaluar një sërë pengesash-embargon e dyfishtë, problemin me emrin, problemet me luftërat kudo në Bosnjë dhe ish-Jugosllavi, problemet në Kosovë dhe Shqipëri, problemet me zgjerimin e shpejtë apo të ngadalshëm të Bashkimit Evropian, pastaj ekonomia nuk është në nivel të duhur, ka shumë politikanë të korruptuar, e kështu me radhë. Por, sidoqoftë, si i shihni arritjet e Maqedonisë si shtet. Sot, ajo qëndron si shoqëri multietnike dhe multikulturore e vetme në Ballkan. Posedon me të vërtetë një qeveri multietnike dhe multikulturore, të cilët nuk janë të interesuar të dinë se sa të holla mund të vjedhin. Me sa mund të vërej, nuk ka më njerëz si Besnik Fetaj. Nuk kam dyshim se çështja e korrupsionit nuk është e eliminuar brenda qeverisë, nuk jam naiv për këtë. Por, qeveria po bën çmos që të jetë një qeveri multietnike dhe multikulturore. Shoh një qeveri që është e përkushtuar për t'i plotësuar standardet e kërkuara nga NATO dhe e cila punon drejt arritjes së pranimi në BE. Para dy vitesh Maqedonia nuk do ta kishte rastin të jetë buzë pranimi të 5000 pyetjeve dhe të jetë 18 muaj larg marrjes së mendimit të përgjithshëm nga BE, opinion ky i Komisionit Evropian jo për atë se a është apo jo e gatshme për t'u pranuar, por për atë se sa është e gatshme dhe çfarë duhet të bëjë për të arritur këtë. Kjo për mua është mbresëlënëse. Fakti se 13 vite nga pavarësia keni përjetuar konflikt të brendshëm, keni përjetuar krime lufte, ku akoma mungojnë njerëzit nga konflikti, Maqedonia mund të ishte atje ku është sot, është diçka për të cilën Maqedonia duhet të jetë e vetëdijshme dhe krenare se ajo gjendet këtu ku është përkundër gjithë asaj çfarë ka ndodhur. Pyetja tani të cilën e diskutuam edhe me grupin sot në takim, është se nuk shoh krizë të re. Po, secili vend ka potencial për kriza, përfshirë edhe vendin tim, por shoh mundësi dhe vullnet për punë. Por njerëzit duhet të pyesin-në cilin drejtim po synojmë dhe kush është i kualifikuar të na shpie atje? Do të jem direkt. A i dëshironi ata njerëz që ju sollën tipa A, apo dëshironi grupin e njerëzve të cilët po bëjnë një progres të madh drejt NATO-s dhe është në prag të pranimi të pyetësorit nga BE që ju shpie në procesin e integritimit. Sapo të arrini atje, nuk ka më kthim prapa. Por, pyetem se në mos maqedonasit paksa ngurrojnë në bërjen e hapit të fundit të pashmagshëm që shpie drejt integritimit evrop-atlantik. Mendoj se ka njerëz në këtë vend që nuk duan të ndodh kjo.



LOBI: Por me referendumin, a nuk e vëmë në pikëpyetje gjithë këtë me implikacionet e mundshme?

Butler: Maqedonia, më shumë se çdo shtet tjetër ku kam pasur punë, ka përjetuar më shumë tragjedi dhe kthime prapa. Këtë vit, Maqedonia duhej të ishte më para se ç'është tani. Ju humbët kryetarin, ne humbëm mikun e Shteteve të Bashkuara dhe një mik edhe të qytetarit të thjeshtë. Përjetuat zgjedhje të parakohshme presidenciale, ndërrim të kryeministrit dhe tani referendumi. Shtete tjera gjithashtu përjetojnë situata të tilla dhe ekzistojnë shtete që nuk janë anëtarë të BE-së dhe ballafaqohen njëloj me probleme. Nuk ka kthim mbrapa. Marrëveshja-kornizë definojnë statusin final të Maqedonisë- dhe kjo është shtet multietnik me integritet territorial dhe sovranitet të pacënuar. Këtu nuk ka kthim prapa. Nëse ndokush ka problem me këtë, atëherë është gabim, kjo nuk do të ndodhë. Do të ketë implikacione. Por është e mundshme, nëse njerëzit nuk janë të kënaqur me ekonominë apo ndjejnë se qeveria nuk komunikon me ta, atëherë ata kanë kapacitetin të ndalin rrugën nga po shkon Maqedonia. Kur përpiqesh ta ndalësh rrjedhën e historisë, veten e sheh të përmbysur nga gjërat që vijnë pas vetes. Tani, nëse pyetemi se a ishte Marrëveshja-kornizë gjëja e duhur, kjo është prapa nesh, kjo ndodhi në vitin 2001 dhe nuk ka kthim mbrapa. E përfunduam 2001 me Marrëveshjen-kornizë dhe me të u krijua një ngjeshje sociale. Kjo ngjeshje është se njerëzit lokalë do të kenë qeveri lokale. Tani, ja ku është sfida për qeverinë. Qeveria duhet të tregojë qartazi në gjashtë javët e ardhshme përse ata kanë vendosur që të kenë numër më të vogël të komunave, ngjeshje më të madhe, larmi më të madhe etnish dhe kushte për mbijetesë dhe ata që thonë se janë bërë vija të prera ndarëse të etnive e kanë gabim. Këtu më duhet t'u drejtohem atyre që thonë se kjo është vizatim i murit ndarës apo kufij të ri brenda Maqedonisë, me siguri po përpiqeni t'u ndihmojnë të tjerëve në tërheqjen e kufijve të rinj. Kam shikuar në prishjen etnike, dhe Nicholas White nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave gjithashtu mendon se ndarja e re në realitet e përmirëson këtë dhe sjell së bashku komunat rurale dhe urbane dhe kështu krijon komuna të qëndrueshme. Dritat po shuhën kudo në Maqedoni. Ato po shuhën pasi njerëzit po shpërngulen apo po vdesin. Dhe kjo është shumë keq pasi e ardhmja e Maqedonisë mund të jetë këtu dhe mund të bëhet pjesë e Evropës. Siç tha edhe Ali Ahmeti, nuk jeni duke ndërtuar kasolla të vogla këtu, por jeni duke ndërtuar pjesë të Evropës së madhe. Pyetja është se ç' duhet bërë qeveria tani dhe më 7 nëntor. Ata duhet të tregojnë se plani i ri është i mirë sikur çdo plan tjetër dhe është i vetmi plan me të cilin po merremi. Nuk kam parë ndonjë plan tjetër alternativ që është më i mirë se ky.

LOBI: Për shumë njerëz ky vit është i humbur. Akoma nuk kemi filluar të merremi me ekonomi që të përgatitim rrugën drejt Evropës.

Butler: Pyetja juaj është qartazi edhe në mendjen e votuesve, në mendjen e njerëzve që u nënshkruan për referendum dhe të cilët besojnë në atë çka u është thënë atyre, se kjo do të ndante Maqedoninë. Disa janë thjeshtë të palumtur. Por unë e di se çfarë ndodh kur njerëzit votojnë "po" ose "jo" apo nuk votojnë fare, kjo më tepër varet nga aftësia e qeverisë dhe aftësia e qytetarëve për të kuptuar cilat janë zgjedhjet. Nëse nuk jeni të lumtur sot, nëse ju apo bashkëshortja juaj nuk ka punë, a do të bëhet më mirë apo më keq duke i thënë "jo" asaj që është pjesë përbërëse e Marrëveshjes-kornizë dhe procesit që e udhëheq në mënyrë të pashmangshme Maqedoninë drejt Evropës. E ardhmja e Maqedonisë është në Evropë. Pyetja është se sa shpejt dëshironi të ndodhë kjo. Mendoj se

maqedonasit mendojnë shumë për fëmijët e tyre dhe se cili lloj i Maqedonisë do të hyjë në Evropën do të jetë rezultat i votimit “për” ose ‘kundër”. Pyetja duhet të jetë se a jam në pozitë më të mirë me ligjin aktual që do të hyjë në fuqi më 1 janar me 84 komuna, e cila është e rëndësishme për standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe e cila po merr dritë jeshile nga NATO dhe BE, apo doni të pushoni dhe të ndaleni të merreni me të gjitha trazirat dhe tollovitë që do të pasojnë?

LOBI: Po, por a janë njerëzit të aftë të jenë racionalë në këtë situatë?

Butler: Kam jetuar në dhe rreth Ballkanit që nga viti 1992. Nga të gjitha vendet ku kam jetuar, Maqedonia është i vetmi vend ku nuk frikësohem aspak se ka lëvizje iracionale. Saherë që maqedonasit janë ballafaquar me zgjedhjen nën rrethana të vështira, ata çdoherë kanë bërë zgjedhjen e duhur.

LOBI: A besoni se qeveria në gjashtë javët e ardhshme do të përcjell mesazhin se ligji i ri është më i mirë sesa ai i vjetri duke marrë parasysh se ata nuk arritën të bëjnë këtë kur ligji ishte në procedurë parlamentare?

Butler: Ndjej keqardhje dhe kam mirëkuptim të plotë se pse qeveria nuk arriti në muajin shkurt, në kohën kur kaloi leximi i parë i ligjit dhe në korrik kur ai u kompletua nga qeveria, të zhvillojë një fushatë publike të fortë për të sqaruar përfitimet e saj. Kjo ndodhi për shkak se ju humbët presidentin, kishit zgjedhje presidenciale dhe u desh të zgjidhni kryeministër të ri dhe kjo është një hutim shumë i madh. I kuptoj sfidat e përpjekjes për të bërë shumë gjëra në të njëjtën kohë. Gjithashtu ligji u rishikua dhe u ndryshua nga partnerët e koalicionit për shkak të presioneve të brendshme, si dhe të opinionëve të shprehura nga qytetarët. Ligji që më në fund u miratua në korrik është 99 % i njejtë si ai që kaloi në muajin shkurt. Për një periudhë gjashtëmujore njerëzit patën rastin ta shohin dhe vendosin se a do të funksionojë. Gjithashtu neve si bashkësi ndërkombëtare na dha një rast ta shikojmë sërish. Qeveria e tashme duhet t’ia sqarojë qytetarëve dhe të jetë e përgjegjshme. Kjo është e mira e demokracisë, se në një periudhë të arsyeshme ke aftësinë që të kërkosh shkarkimin e qeverisë dhe të kërkosh qeveri të re dhe ta ndryshosh atë. Njerëzit duhet të kuptojnë se cilat do të jenë pasojat nëse thonë “po” më 7 nëntor. Do të varet nga qytetarët. Do të jetë një periudhë interesante prej gjashtë javësh. Qeveria ka rastin, por se a do të ketë sukses nuk e di. Pa dyshim shpresoj se do të ketë sukses dhe besoj se ata e kuptojnë nevojën për të vepruar këtë. Është gjithashtu e rëndësishme që opinionin e bashkësisë ndërkombëtare t’iu tregohet mediave. Ky opinion është se ne nuk kemi asnjë problem me ligjin e nxjerrë. Por, kjo nuk do të thotë se nuk do të ishim dakord për ndonjë ligj tjetër, porse ky ishte i vetmi i parashtruar. Shohim disa nga ata të opozitës se si janë të motivuar për të kaluar sërish në pozitë dhe këtë mund ta bëjnë ose në vitin 2006 ose tani. Por ekziston kërkesa për ta implementuar Marrëveshjen-kornizë. Nëse Maqedonia vendos që mos ta implementojë këtë marrëveshje duke votuar kundër saj, atëherë kalojmë në një periudhë të qëndrimit në vend. NATO nuk lëviz para, por ju nuk afroheni, pasi ju, qytetarët e Maqedonisë kanë zgjedhur të ndalen. Nuk e shoh këtë si anti-shqiptare, anti-NATO, apo anti-qeverisë. Nuk e di cilat janë motivimet, por e di cilat mund të jenë implikacionet. Nëse e zgjidhni këtë rrugë, këto janë rezultatet. Nëse referendumi refuzohet, nëse ligji aktual mbetet në libër, gjëja më e keqe që mund të ndodhë është se në vitin 2006 mund të zgjedhet qeveria e re e cila do ta ndryshojë nëse

nuk funksion. Ndërkohë, Marrëveshja-kornizë është implementuar dhe ju po shkoni drejt NATO-s.

LOBI: Këtu jeni që disa vite dhe keni eksperiencë të madhe në punën me politikanët tanë. Cili është mendimi juaj për kapacitetin e tyre politik?

Butler: Politikanët janë me siguri grupi i njerëzve më i kritikuar që njoh. Ata janë gjithashtu njerëzit më të vyeshëm, të cilët punojnë në shumë raste për shumë të vogël të hollash dhe për shumë të vogël të respektit dhe reputacionit. Politikanët me të cilët kam punuar në Maqedoni janë politikanë shumë të mirë.

Ka shumë pak politikanë vendas të mirë. Ne po investojmë në krijimin e politikanëve të mirë. Edhe IRI edhe NDI (Nansen Dialogue Institute) kanë programe për të ndihmuar në zhvillimin e kapacitetit të politikanëve lokalë duke parandjerë zgjedhjet e reja në muajin mars të vitit të ardhshëm, të cilët do të garojnë për poste në këshilla komunale apo për postin e kryetarëve komunalë. Tani, nuk ka shumë përgjegjësi nëse je anëtar i këshillit komunal, mungojnë të hollat. Politikanëve të cilëve më shumë iu admirohem janë ata që kanë aftësi për të rritur të hollat nga qeveria apo donatorët e jashtëm.

Në këtë drejtim, ekzistojnë shumë njerëz të mirë, e cila është e pazakonshme.

Në nivel kombëtar, mendoj se ka politikanë shumë të mirë. Disa mund të thonë se ata janë më shumë të brengosur për strukturat e partive politike. Dhe këtu edhe ju edhe unë e di se po flasim për një numër të partive politike që janë në proces të prishjes.

LOBI: Jemi të vetëdijshëm se çfarë po ndodh me VMRO-DPMNE. LSDM-ja do të ballafaqohet me zgjedhjen e kryetarit të ri të partisë. Ekziston mendimi se BDI-ja është akoma në proces të formimit si parti, sepse edhe pas tre viteve, ata akoma nuk kanë pasur kongresin e tyre të parë. Kështu që, të dy partitë më të forta po ballafaqohen me probleme dhe relacione të brendshme. A mendoni se kjo do të krijojë probleme plotësuese?

Butler: Vëzhgimi im për BDI-në si parti politike është se si parti më e re në Maqedoni, e formuar nga pothuajse asgjë, po zhvillohet në një parti politike shumë efektive. Tani, nuk e di në aspekt teknik e ligjor, por mënyra se si sillen në grup parlamentar dhe në lidhshmëri partiak është shumë e fuqishme dhe efektive. LSDM-ja ka një traditë të gjatë. Jemi duke shikuar se çfarë po ndodh brenda VMRO-së. Mendojmë se është me rëndësi që çdo shtet, çdo demokraci ka nevojë për opozitë të fuqishme që partia qeveritare të jetë përgjegjëse. Kjo është me rëndësi. Por, nuk shoh asnjë problem në çështjet e lidhshmërisë të brendshme të cilave ju referoheni, mendoj se ato janë të zakonshme në demokraci. Ka kaluar një kohë që kur kemi parë të lind një parti e re dhe kjo me të vërtetë është një sfidë. Kur bëhet fjalë për VMRO, kjo është një çështje tjetër. Punojmë afër me VMRO-DPMNE dhe e shohim si një qendër legjitime të partisë qendrore, një balans i koalicionit qeveritar.

LOBI: Spekullohet se formimi i një partie të re shqiptare do të bëhet me mbështetjen e disa përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare. Spekullohet gjithashtu se disa nga diplomatët po marrin anë në konfliktin e brendshëm të VMRO-së, madje edhe duke mos iu lëshuar viza. A keni ndonjë koment për këtë?

Butler: Mendoj se do të ishte e papërgjegjshme që diplomatët e huaj të përzihen në krijimin e një partie të re politike, përveç nëse jemi në ndonjë shtet me probleme të vërteta të demokracisë. Mund t'ju tregoj shembuj ku jemi të përfshirë në mënyrë aktive

dhe kemi ndihmuar në formimin e partisë në regjim të diktaturës ose komunizmit. Nuk e di ku është krijuar ky spekulim. Nuk kam njohuri aspak se ndonjëri nga bashkësia ndërkombëtare është i përfshirë në këtë.

Ne po ashtu nuk marrim anën në politikën e brendshme të partive. Ajo çfarë ndodh brenda VMRO-së varet nga njerëzit dhe vetë VMRO-ja. Ajo çfarë i ndodhi z. Georgievskit me refuzimin e vizës ka qenë vendim i marrë në SHBA, në bazë të arsyeve të përmendura në urdhrin ekzekutiv dhe nuk ka të bëjë fare me çështjet e brendshme politike.

LOBI: Përse nuk jeni aq aktual në media kohëve të fundit, siç ishit më parë? A është kjo për shkak të zgjedhjeve të ardhshme në SHBA?

Butler: Në ekonomi përdoret termi përshtatje e sezonës. Kjo është sikur kur krahasoni muajt qershor dhe maj, e cila mund të jetë një krahasim jo i mirë pasi njerëzit shkojnë për pushime në muajin qershor. Nuk mendoj se po bëj më shumë apo më pak, mendoj se ka qenë për shkak të stinës së verës. Por definitivisht, nuk ka të bëjë asgjë me zgjedhjet në SHBA.

LOBI: SHBA po ndihmon shumë nëpërmjet USAID. A jeni të kënaqur me shumën e të hollave dhe përpjekjeve në fusha të ndryshme dhe rezultatet e dala?

Butler: Me USAID kemi dy qëllime. Njëra ka qenë e shkurtër, me efekt të shpejtë, që kishte të bëjë me trajtimin e pasojave nga konflikti. Dhe kjo do të përfundojë me iniciativat kalimtare, iniciativat e CBI, të cilat zhvilloheshin në rajonet e prekura nga konflikti dhe u mundua të lehtësojë disa goditje. Pjesa tjetër e USAID është më afat-gjate dhe ata përpiqen të ndërtojnë themel dhe strukturë të re për të ardhmen. Një nga këto është fusha e arsimit. Kjo është risi dhe jam i kënaqur që kemi zgjedhur diçka që Maqedonisë do t'i paguaj dividendë afatgjate, e cila është arsim i kualitetit të nivelit të mesëm dhe nivelit të tretë ndërkombëtar evropian. Është një ndihmë për Maqedoninë që të tejkalojë periudhën e tranzicionit dhe të shkojë direkt atje ku është Evropa. Në anën ekonomike, më duhet të them se është një fushë ku nuk jam aq i kënaqur. Mendoj se njerëzit tanë politik janë të frustruar me tempin e reformave ekonomike. Mendojmë se reformat duhet të zbatohen më shpejtë dhe duhet të ketë më pak urdhra dhe rregulla. Do të thoja se qeveria juaj duhet të jetë më e vogël dhe të kuptojë se si mund të del nga rruga e biznesmenëve. Qeveria maqedonase është akoma e ngathët në rrugën e sektorit privat. Nevojiten shumë përpjekje për fillimin e cilësdo kompani. Ka shumë ministri, shumë leje dhe shumë pengesa burokratike që duhet t'i kapërceni. Sektori tjetër ku mendoj se mund të shohim ndonjë rezultat janë reformat ligjore. Deri më tani, kam qenë më të vërtetë i pakënaqur me reformat në gjyqësi. Ne investonim në proces më të mirë organizues sepse gjykatat maqedonase janë të "varrosura" në raste të parëndësishme. Ne iu kemi ndihmuar se si të krijojnë mekanizma për procese më të mira dhe më të shpejta dhe në këtë mënyrë ata do të koncentroheshin në raste më të rëndësishme komerciale dhe kriminale. Kisha frustracione me mosvullnetin e gjyqësisë maqedonase të disiplinës së brendshme. Nëse një gjyqtar korruptohet, apo është fajtor për moskryerje të duhur të detyrës, si mund të jetë ai i disiplinuar. Kam marrë shënime kur gjatë javës së kaluar, Këshilli Republikan i gjykatave njohtoi për largimin e tre personave për moskryerjen e detyrës në rastin e Izair Samiut. Dhe unë thashë: "Bravo". A janë apo nuk janë fajtorë, nuk e di, por këshilli i gjykatave eci para dhe tha – ju tre nuk e kryeni punën si duhet dhe për këtë duhet të

largoheni. Kjo është shumë e rëndësishme. Kjo dërgon mesazh të çdo gjykatës në vend se nuk janë të paprekshëm dhe se nuk mund të rrinë dhe të pretendojnë se nuk do të merren në përgjegjësi nëse pranojnë mitë. Nëse bën gabim, rrezikon ta humbasish punën, kështu që mos bëj gabime.

LOBI: A jeni i kënaqur me bashkëpunimin në nivele të ndryshme me qeverinë?

Butler: Ne kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm çdokund në qeveri. Kolegët e mi në ambasadë ose në pjesë tjera të misionit, kanë qasje dhe kontakte personale në çdo nivel. Mendoj se ata frustrohen me burokracinë dhe pengesat ligjore në zbatimin e reformave. Është fakt se gjatë tre viteve të fundit udhëheqësit më të vjetër kanë qenë më të fokusuar në çështjet e sigurisë dhe nuk kanë pasur mundësi të fokusohen në reformat e brendshme. Kjo është ajo për të cilën duhet të mendojnë votuesit maqedonas. T'i tregojnë Hari Kostovit dhe njerëzve të tij se kanë vetëm edhe dy vjet për t'i lëvizur gjërat ose do të humbin punën e tyre.

LOBI: Hari Kostov deri më tani nuk ka pasur rast që të punojë...

Butler: Po, e di. Dhe nëse më 7 nëntor thoni "po", ai asnjëherë nuk do ta ketë më këtë rast. Pra, pyetja e ardhshme është: Kush do të jetë në vend të tij? Lubço Georgievski, Zingo apo Tupurkovski?

LOBI: Po puna me Ambasadën, a do të mbaroni punimet para përfundimit të mandatit tuaj këtu?

Butler: Pres që të qëndroj këtu deri në vitin e ardhshëm. Edhe po të fillonim ta ndërtonim nesër, nuk do të arrinim ta përfundonim deri në atë kohë sa do të jem këtu. Plani është që ambasada do të jetë e ndërtuar në vitin 2007. Jemi në përputhje të kohës. Simbolika e ndërtimit të Ambasadës në anën tjetër të Vardarit është diçka në të cilën nuk jemi fokusuar. Së pari, nuk është ambasadë rezidenciale, askush nuk do të jetojë atje. Do të jetë vend ku do të punojmë, ku do të vijnë kërkesat për vizë dhe kjo do të thotë se askush nuk do të jetë aty në mbrëmje. Mendoj se është një vend që nuk vizitohet nga njerëz në mbrëmje. Do të jetë një investim prej më shumë se 50 milionë dollarëve dhe shumica e këtyre të hollave do të harxhohen në Maqedoni. Në mënyra të shumta, kjo do të jetë investimi më i madh i huaj në dy vitet e ardhshme në Maqedoni, ndoshta edhe më i madh se ai i z. Koç. Ambasada do të jetë simbol permanent i përkushtimit amerikan në këtë vend. Ne jemi këtu për të qëndruar.

###